Agro & Social Fund
sh.p.k

# ANNUAL REPORT
# RAPORT VJETOR

# 2016

www.asf.al

# Përmbajtja

# *Content*


Zhvillimi Institucional/ *Institutional Development* 3

Misioni & Vlerat Thelbësore /*Mission & Core Values* 4

Mesazhi nga Drejtori Ekzekutiv /*Message from the Executive Director* 6

Arritjet 2016 / *Achievements 2016* 8

Agro & Social Fund në Shifra / *Agro & Social Fund in Figures* 9

Bilanci / *Balance Sheet* 10

Pasqyra e të Ardhurave / *Income Statement* 11

Pasqyra e Flukseve të Parasë / *Cash Flow Statement* 12

Raporti i Auditorëve të Pavarur / *Independent Auditor's Report* 14

Performanca Sociale / *Social Performance* 16

Klientët Tanë / *Our Clients* 17

Partnerët / *Partners* 20

# Zhvillimi Historik i Institucionit

# *Historical Institutional Development*

Agro & Social Fund është themeluar në vitin 2001 e njohur me emrin Building Future (Programi mikrofinanciar i Word Vision Albania), në 2010 institucioni mori emrin Vision Fund Albania.
Që prej Janar 2017, Agro & Social Fund është nën drejtimin e aksionerit te ri "Fondi Besa".
Agro & Social Fund është licensuar nga Banka e Shqipërisë si Institucion Financiar Jo-Bankë që nga viti 2010.

*Agro & Social Fund was established in 2001 known as Building Future (Microfinance programme of Word Vision Albania), in 2010 the institution was renamed Vision Fund Albania.*
*Since January 2017, Agro & Social Fund has a new shareholder, "Fondi Besa".*
*Agro & Social Fund obtained the license from the Bank of Albania to operate as a Non-Bank Financial Institution since 2010.*

## Degët e Agro & Social Fund / *Agro & Social Fund Branches:*

***Zyra Qëndrore***
Rruga "Pjeter Bogdani"
Pallati 23/4, Kati II, Tiranë, Shqipëri
***www.asfund.org***

***Head Office***
Street "Pjeter Bogdani"
Building 23/4, Floor II, Tirana, Albania
***www.asfund.org***

**Lezhë** – që prej vitit 2001
**Korçë** - që prej vitit 2003
**Laç** - që prej vitit 2007
**Librazhd** - që prej vitit 2008
**Elbasan** - që prej vitit 2010

**Lezhë** – since 2001
**Korçë** - since 2003
**Laç** - since 2007
**Librazhd** - since 2008
**Elbasan** - since 2010

# Misioni i Agro & Social Fund

## *Mission of Agro & Social*

Agro & Social Fund është një Institucion Financiar i orientuar drejt zhvillimit, dhe me fokus social, veçanërisht në sektorin agro dhe bizneset e vogla e të mesme, në zonat rurale dhe zonat urbane. Ne ofrojmë shërbim cilësor, vlerësojmë respektin, transparencën në komunikim, konfidencialitetin, mosdiskriminimin dhe evitimin e mbingarkesës me borxhe. Fokusi ynë është financimi, forcimi i këtyre aktiviteteve, përmirësimi i jetës në komunitete, sepse jemi të bindur që në këtë mënyrë luftojmë varfërinë dhe këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe japin një kontribut thelbësor në ekonominë e vendit. Aksionerët tanë presin një fitim të qëndrueshëm nga investimi, por nuk janë të interesuar vetëm për maksimizimin afatshkurtër të fitimit por duke vendosur në fokus edhe anën sociale të Institucionit.

*Agro & Social Fund is a Financial Institution oriented toward development, and social focus, especially in agro, small and medium business sector, in rural and urban areas. We offer quality services, value respect, transparency in communication, confidentiality, non-discrimination and avoidance of over debt. Our focus is financing, strengthening of these activities, improvement of life in the community, because we are convinced that in this way we fight poverty and these businesses create the largest number of jobs and make a vital contribution to the economy. Our shareholders expect a sustainable return on investment, but they are not interested only in short-term profit maximization but they are also focused on the social side of the Institution.*

# Vlerat e Agro & Social Fund

Agro & Social Fund sh.p.k

## Values Of Agro & Social Fund



# Mesazhi i Drejtorit Ekzekutiv

Agro & Social Fund sh.p.k



**I nderuar lexues,**

Viti 2016 e përballi Agro & Social Fund me procesin e ndryshimit të aksionerit të kompanisë, proces i cili u përmbyll me sukses në fund të vitit 2016, me kalimin e pronësisë së kompanisë, me 100%, tek Fondi Besa sh.a.

Qëllimi kryesor i këtij procesi ishte jo thjesht shitja e kompanisë por gjetja e aksionerëve të përshtatshëm të cilët do të drejtonin dhe zhvillonin kompaninë në rrugën e nisur, duke siguruar si performancën financiare ashtu dhe atë sociale.

Pavarësisht kësaj, kompania ka vijuar të zhvillojë aktivitetin e saj duke iu shërbyer me përkushtim klientëve.

Disa nga arritjet e Agro & Social Fund:

- Gjatë 2016 A&S Fund ka **disbursuar 894 kredi** me një vlerë totale prej rreth **189 Milion Lekë**.
- Në fund të vitit 2016, A & S Fund rezulton me **1,546 klientë aktivë** dhe një **volum kredie aktive prej 250.4 Milion Lekë,** dhe ka ndikuar në jetën e **2,397 fëmijëve** në sajë të punës së saj**.**
- A & S Fund ka vijuar të jetë një partner i besueshëm me Institucionin Mikrofinanciar jo fitim-prurës, KIVA, duke financuar **26 % të portofolit** të saj nëpërmjet këtyre fondeve. Në sajë të këtij bashkëpunimi janë financuar me kredi **407 klient** me një volum të disbursuar prej **58 Milion Lekë,** për vitin 2016. Klientët e financuar nëpërmjet këtij partneriteti përfshijnë kategoritë më në nevojë të shoqërisë si dhe komunitetet etnike si Romë, Egjyptian etj.
- Agro & Social Fund në fund të 2016, rezulton me një portofol prej 66% të investuar në në zonat rurale, si dhe me 50% të klientëve aktivë femra.
- A&S Fund ruan marrëdhënie të ngushta me Shoqatën e Institucioneve të Mikrofinancës në Shqipëri dhe Microfinance Center me qëllim që të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme përpjekjet e saj për të ofruar produkte dhe shërbime në të mirë të klientëve, si dhe për të qenë në koherencë me zhvillimet në treg.

Si Drejtor Ekzekutiv i Agro & Social Fund që prej Janarit të vitit 2017, do të doja të ndaja me ju disa nga synimet e kompanisë për vitin 2017, ku fokusi ynë kryesor do të jetë:

- Përmirësimi i performancës financiare të kompanisë
- Zgjerimi i kompanisë me degë të reja
- Përmirësimi i treguesve socialë të portofolit të kredisë

Raporti në vijim, do t'ju njohë me punën dhe arritjet e institucionit gjatë vitit 2016.

**Kujtim BUMÇI**
Drejtor Ekzekutiv

# Message of Executive Director

**Dear reader,**

During 2016, Agro & Social Fund was faced with the process of changing the ownership of the company, a process which was successfully concluded at the end of 2016, by transferring 100% of the ownership to "Besa Fund". The main goal of this process was not simply selling the company but also finding suitable shareholders who would lead and develop the company, providing both financial and social performance.

Despite this, the company has continued to develop its activity by serving customers with dedication.

During 2016 there have been some achievements for Agro & Social Fund:

- In 2016 A & S Fund has **disbursed 894 loans** with a total value of about **189 million ALL**.
- In 2016, A & S Fund resulting in **1,546 active clients** and an active loan volume of **250.4 million ALL**, and has impacted **2,397 children**.
- A & S Fund continues to be a reliable partner of KIVA, a non-profit organization. Thanks to this cooperation, during 2016, there are financed **407 clients** or **26% of its portfolio**, with a volume of disbursement of **58 million ALL**. Clients funded through this partnership include the most vulnerable categories of society in Albania and ethnic communities as Roma, Egyptian etc.
- A & S Fund maintains close relations with the Association of Microfinance Institutions in Albania and Microfinance Center in order to improve continuously its efforts to provide better products and services to the clients and to be in coherence with developments in this market.

As Executive Director of Agro & Social Fund since January of 2017, I would like to share with you some of the company's goals for 2017, where our main focus will be:

- Improving the company's financial performance
- Expansion of the company with new branches
- Improving social indicators of the loan portfolio

The following report will give you an understanding of the institution's work and achievements during 2016.

**Kujtim BUMÇI**
Executive Director

# Achievements 2016




| | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Mars 2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kursi i kembimit Usd/Lek | 134 | 131 | 102.8 | 89.2 | 103.6 | 94.14 | 82.89 | 87.91 | 95.81 | 104 | 107.5 | 105.85 | 101.86 | 115.23 | 125.79 | 128.17 | 127.34 | Exchange rate Usd/Lek |
| Numri i Kredive Aktive | 25 | 70 | 392 | 847 | 1,229 | 1,646 | 1,690 | 1,623 | 2,126 | 2,459 | 2,381 | 2,625 | 2,448 | 2,098 | 1,809 | 1,546 | 1,535 | Active loan number |
| Portofoli i Kredise (milion Lek) | 8.16 | 13.81 | 49.14 | 74.86 | 118.38 | 154.12 | 125.92 | 123.81 | 202.58 | 215.25 | 219.96 | 239.50 | 242.13 | 260.00 | 275.56 | 250.40 | 259.56 | Loan Portofolio (million Lek) |




| | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Mars 2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kursi i kembimit Usd/Lek | 134 | 131 | 102.8 | 89.2 | 103.6 | 94.14 | 82.89 | 87.91 | 95.81 | 104 | 107.5 | 105.85 | 101.86 | 115.23 | 125.79 | 128.17 | 127.34 | Exchange rate Usd/Lek |
| Numri i Kredive te disb/vit | 27 | 84 | 404 | 790 | 1,132 | 1,502 | 1,448 | 1,626 | 2,083 | 1,902 | 1,837 | 1,990 | 1,682 | 1,366 | 1,157 | 894 | 266 | No. of Loans Disb.Annually |
| Shuma e Disbursuar ne vit (milion Lek) | 13.90 | 23.36 | 62.97 | 112.29 | 169.72 | 222.20 | 181.48 | 177.05 | 255.93 | 236.28 | 244.47 | 261.07 | 247.40 | 252.43 | 251.47 | 189.25 | 62.33 | Amount Disbursed Annually (million Lek) |




| | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Mars 2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kursi i kembimit Usd/Lek | 134 | 131 | 102.8 | 89.2 | 103.6 | 94.14 | 82.89 | 87.91 | 95.81 | 104 | 107.5 | 105.85 | 101.86 | 115.23 | 125.79 | 128.17 | 127.34 | Exchange rate Usd/Lek |
| Numri i kumulativ i kredive | 27 | 111 | 515 | 1305 | 2,437 | 3,939 | 5,387 | 7,013 | 9,096 | 10,998 | 12,835 | 14,825 | 16,507 | 17,873 | 19,030 | 19,924 | 20,190 | Cumulative Number of Loans |
| Shuma kumulative e disbursuar (milion Lek) | 13.90 | 37.26 | 100.23 | 212.52 | 382.24 | 604.44 | 785.92 | 962.97 | 1,218.89 | 1,455.17 | 1,699.65 | 1,960.71 | 2,208.11 | 2,460.55 | 2,712.01 | 2,901.26 | 2,963.59 | Cumulative Amount Disbursed (million Lek) |

# Agro & Social Fund në shifra

# *Agro & Social Fund in Figures*

| | |
|---|---|
| Kapitali/<br>Equity | 187,190,000 leke (ALL) |
| Totali i Aseteve/<br>Total Assets | 259,951,000 leke (ALL) |
| Raporti Kapital/Portofol<br>Equity/Loan Portfolio Ratio | 74.75% |
| Teprica e Kredive Aktive<br>Outstanding Loan Portfolio | 250,400,000 leke (ALL) |
| Nr. kumulativ i Klientëve<br>Cumulative No.of Clients | 19,924 |

| | |
|---|---|
| Klientë Aktivë<br>Active Clients | 1,546 |
| Klientë Aktivë Femra<br>Active Female Clients | 50% |
| Numri i Punësimeve të Impaktuara<br>Number of Jobs Sustained | 2,220 |
| Numri i Klientëve Ruralë<br>Number of Rural Borrowers | 66% |
| Numri i Fëmijëve të Impaktuar<br>Number of Impacted Children | 2,397 |

# Bilanci

# *Balance sheet*

| *(Shumat në mijë Lek)* | | | *(Amounts in thousands of Lek)* |
|---|---|---|---|
| | **2016** | **2015** | |
| **Aktivet** | | | **Assets** |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet me to | 11,384 | 8,475 | Cash and cash equivalents |
| Hua dhe paradhënie për klientët | 244,385 | 266,917 | Loans and advances to customers |
| Aktivet afatgjata materiale | 2,606 | 4,712 | Property and Equipment |
| Aktive të tjera | 1,576 | 1,021 | Other assets |
| Tatimi mbi fitimin i parapaguar | - | 164 | Prepaid income tax |
| **Totali i aktiveve** | **259,951** | **281,289** | **Total assets** |
| | | | |
| **Detyrimet dhe Kapitali i vet** | | | **Liabilities and shareholder's equity** |
| **Detyrimet** | | | **Liabilities** |
| Hua dhe qira financiare | 66,793 | 221,909 | Borrowings and finance lease |
| Grante | 266 | 379 | Grants |
| Detyrime të tjera | 5,616 | 5,451 | Other liabilities |
| Tatimi mbi fitimin i pagueshem | 86 | - | Income tax payable |
| | **72,761** | **227,739** | |
| **Kapitali i vet** | | | **Shareholder's equity** |
| Kapitali aksionar | 289,375 | 156,200 | Share capital |
| Humbje të mbartura | (96,868) | (97,333) | Accumulated losses |
| Rezerva të tjera | (5,317) | (5,317) | Other reserves |
| | **187,190** | **53,550** | |
| **Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet** | **259,951** | **281,289** | **Total liabilities and shareholder's equity** |

# Pasqyra e të ardhurave

## *Income statement*

| *(Shumat në mijë Lek)* | | | *(Amounts in thousands of Lek)* |
|---|---|---|---|
| | **2016** | **2015** | |
| Interesa | | | Interest |
| Të ardhura nga interesi | 79,635 | 79,630 | Interest income |
| Shpenzime për interesa | (21,882) | (22,963) | Interest expense |
| Të ardhura neto nga interest | **57,753** | **56,667** | Net interest margin |
| Të ardhura të tjera | 6,951 | 15,108 | Other income |
| Shpenzime operative | | | Operating expenses |
| Zhvlerësimi | (2,253) | (3,411) | Depreciation |
| Shpenzime personeli | (33,914) | (34,923) | Personnel |
| Humbje nga zhvlerësimi i huave | (5,726) | (10,051) | Impairment losses on loans to customers |
| Shpenzime të tjera | (20,317) | (21,871) | Other expenses |
| Fitim/(humbje) neto nga kurset e këmbimit | (1,779) | (3,139) | Net foreign exchange gain/(loss) |
| Totali i shpenzimeve operative | **(63,989)** | **(73,395)** | Total operating expense |
| | | | |
| **Fitim/(humbja) përpara tatimit** | **715** | **(1,620)** | **Profit/(loss) before income tax** |
| | | | |
| Tatim fitimi | (250) | - | Income tax |
| **Fitim/(humbja) për vitin** | **465** | **(1,620)** | **Profit/ (loss) for the year** |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit | - | - | Other comprehensive income, net of income tax |
| **Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin** | **465** | **(1,620)** | **Total comprehensive profit/ (loss) for the year** |

# Pasqyra e flukseve të parasë

## *Cash flow statement*

| *(Shumat në mijë Lek)* | **2016** | **2015** | *(Amounts in thousand Lek)* |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **Flukset monetare nga aktivitete operacionale** | | | **Cash flow from operating activities** |
| Humbja për vitin | **465** | **(1,620)** | Loss for the year |
| *Korrigjime për:* | | | *Adjustments for:* |
| Zhvlerësimi | 2,253 | 3,411 | Depreciation |
| Humbje nga zhvlerësimi i huave | 5,726 | 10,051 | Impairment losses on loans to customers |
| Amortizim i granteve | (113) | (1,871) | Grant amortization |
| Të ardhura nga interesi | (79,635) | (79,630) | Interest income |
| Shpenzime për interesa | 21,882 | 22,963 | Interest expenses |
| Shpenzime për tatim fitimin | 250 | - | Tax expense |
| Ndryshime në: | | | Changes in: |
| Hua dhe paradhënie për klientët | 20,218 | (30,159) | Loans to customers |
| Aktive të tjera | (555) | 535 | Other assets |
| Detyrime të tjera | 165 | 2,899 | Other liabilities |
| **Flukset monetare të përdorura në aktivitete operacionale** | **(29,344)** | **(73,421)** | **Net cash used in operating activities** |
| | | | |
| Interesi i arkëtuar | 76,223 | 79,295 | Interest received |
| Interesi i paguar | (22,350) | (22,518) | Interest paid |
| **Flukset monetare nga/ (të përdorura) në aktivitete operacionale** | **24,529** | **(16,644)** | **Net cash from/ (used in) operating activities** |

# Values Of Agro & Social Fund

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Flukset monetare nga aktivitete investuese** | | | **Cash flows from investing activities** |
| (Shtesa)/ pakësime neto në aktivet afatgjata materiale | (147) | (634) | Net (additions)/disposals of property, equipment |
| **Flukset monetare përdorur në aktivitete investuese** | **(147)** | **(634)** | **Net cash used in investing activities** |
| **Flukset monetare nga aktivitete financuese** | | | **Cash flows in financing activities** |
| Fonde të (paguara)/ marra si hua dhe qira financiare | (21,473) | 9,477 | (Repayments)/proceeds from borrowings and lease |
| **Flukset monetare përdorur në aktivitete investuese** | **(21,473)** | **9,477** | **Net cash (used in)/from financing activities** |
| Rritja/ (rënia) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to | 2,909 | (7,801) | Net increase/(decrease) in cash and cash equivalents |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit | **8,475** | **16,276** | Cash and cash equivalents at the beginning of the year |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit (shënimi 6)** | **11,384** | **8,475** | **Cash and cash equivalents at the end of the year** |

# Performanca Sociale

## *Social Performance*

**Gjatë vitit 2016 Departamenti i Performancës Sociale ka realizuar disa tregues të rëndësishëm si:**

- Ngritje Fondesh nëpërmjet Kiva-s, 58 Milion Lekë, 407 klientë
- Agro & Social Fund i ka shërbyer 19,924 familjeve në nevojë me një vlerë totale të kredive të disbursuara 2,901 Milionë Lekë që nga fillimi i saj në 2001 deri ne fund të 2016.
- 50 % e klientëve të Agro & Social Fund janë femra
- 66% e klientëve të Agro & Social Fund jetojnë në zonat rurale
- 2,397 fëmijë, janë impaktuar gjatë vitit 2016
- Agro & Social Fund ka realizuar gjatë 2016 bashkëpunime për projekte të kredive start-up

***During 2016 the Department of Social Performance has achieved some important indicators such as:***

- *Fundraising through Kiva-s, 58 million ALL, 407 clients;*
- *Agro & Social Fund has served 19,924 poor families with a total value of disbursed loans 2,901 million ALL from its starting of operations in 2001 up to end of 2016*
- *50% of clients of Agro & Social Fund are women*
- *66% of clients of Agro & Social Fund live in rural areas*
- *There are impacted 2,397 children, during the year 2016*
- *Agro & Social Fund has implemented during 2016, cooperation projects for the start-up loans*

# Our Clients

## Edlira Limoni



*"Falë Agro & Social Fund, unë arrita të shkolloj fëmijët e mi dhe të shfrytëzoj mundësitë që më janë ofruar per t'u fuqizuar ekonomikisht"– shprehet Edlira.*

Edlira eshte nje zonjë 43 vjec qe i përket komunitetit Egjiptian. Ajo jeton në fshatin Bulgarec të Korçës me bashkëshortin dhe dy fëmijët. Është kliente për të katërtën herë në këtë institucion dhe në të gjitha rastet, ka arritur t'i shlyejë detyrimet me sukses.

Vështirësitë e këtij komuniteti për t'u integruar e forcuar financiarisht janë ende të pranishme, megjithatë, Edlira konfirmon që këto ka arritur t'i kapërcejë falë mbështetjes që Agro & Social Fund (A & S Fund) i ka shfaqur prej fillimit.

Angazhimi kryesor i familjes së Edlirës është blegtoria. Nëpërmjet njërës prej kredive të marra në A & S Fund, ajo shfrytezoi mundësinë që ju krijua për të blerë një lopë me një çmim të mirë. Sot ajo ka në total tre lopë dhe sasia e qumështit të prodhuar është më e madhe. Çdo mëngjes bashkëshorti i saj niset me biçikletë për në qytet ku shet qumështin tek klientët e tyre besnikë prej vitesh.

Falë dy kredive të tjera që Edlira ka marrë tek A & S Fund, ka mundur të dërgojë fëmijët e saj në shkollë dhe të mbulojë shpenzimet e studimeve të tyre.



***"Thanks to Agro & Social Fund, I made possible to send my children to school and to take the opportunities I have had to empower economically "*** *– says Edlira.*

*Edlira is a 43-year-old woman and is member of the ethnic Egyptian Albanian community. She lives with her husband and two children in the village of Bulgarec, Korce. She is client for the fourth time in our institution and each time she has successfully paid back the loans.*

*The difficulties of this community to be integrated in the society and to empower them financially are still present but Edlira confirms that has exceeded these obstacles through the Agro & Social Fund support from the beginning,*

*The main activity of this family has been livestock. Through one of the loans she took at A & S Fund, she had the opportunity to buy a cow with an occasional price. Today she has three dairy cows and the total quantity of the milk is increased. Every morning, her husband goes to the city with his bicycle to sell the milk to his loyal clients.*

*Thanks to two other loans at A & S Fund, Edlira made possible to send her children to school and to pay their tuition fees.*

# Our Clients

## Rasim Malecaj



*-"Agro & Social Fund ka mbështetur aktivitetin tim që prej fillimit" – pohon Rasimi në intervistë.*

Rasim është babai fatlum i pesë fëmijëve, ku dy më të vegjëlit e familjes janë binjakë. Jeton në Balldre të Lezhës dhe ekonominë e familjes e ka mbështetur në rritjen e zogjve të pulave dhe shitjen e tyre dhe të vezëve në treg. Që kur ndërmori këtë veprimtari, Rasim e dinte qe i vetëm nuk mund t'ia dilte dot. Për këtë, ju drejtua A & S Fund që i është përgjigjur kërkesave të tij cdo herë. Me kredinë e parë, ai ndërtoi një ambjent të posatcëm për rritjen e këtyre zogjve. Më pas, me katër kreditë e tjera që ka marrë në këtë institucion, Rasimi rriti numrin e zogjve vit pas viti si dhe siguroi ushqim të mjaftueshëm për ta.

Rasimi e filloi aktivitetin e tij me 700 zogj dhe sot ai numëron 2200 të tillë. Të ardhurat e tij prej shitjes së tyre janë rritur ndjeshëm dhe Rasimi ndjehet shumë mirënjohës ndaj A & S Fund. Falë këtyre kredive dhe dedikimit të Rasimit dhe bashkëshortes së tij, fëmiljët e tyre sot kanë mundësi më të mira jetese.



***"Agro & Social Fund has supported my activity from the beginning" – affirms Rasim in the interview.***

*Rasim is a proud father of five children and the youngest are twins. He lives in the village of Balldre, Lezhe and the economy of the family is based in poultry, in raising and selling chickens and eggs in the market. Since the moment he undertook this activity, Rasim knew that he couldn't do anything alone without any support. Therefore, he applied for a loan at A & S Fund which has helped him financially every time he needed.*

*With the first loan, he built an appropriate stable to raise these hens. Then, with the other loans he took, Rasim increased the number of the hens year by year and provided enough feed for them.*

*Rasim started this activity with 700 hens and today he counts 2200. The incomes from selling are increased significantly and Rasim feels very grateful to A & S Fund. Thanks to these loans and to the dedication of Rasim and his wife, today their children live in better conditions.*

# Our Clients

## Hatixhe Balla



*"Më ndihmën e Agro & Social Fund, kam arritur të përmirësoj kushtet e jetesës të familjes sime" – shprehet Hatixhe.*

Hatixhe është 65 vjec dhe është nëna "heroinë" e gjashtë fëmijëve, një pjesë e të cilëve janë ende në marrëdhënie shkolle. Bashkëshorti i saj është i paralizuar dhe Hatixhe duhet të luftojë e vetme për të siguruar të ardhurat e familjes. Ata jetojnë në fshatin Griqan Poshtë, Elbasan.

Në vitin 2011, Hatixhe aplikoi tek A & S Fund dhe mori kredinë e parë. Atë e perdori për bujqësi që është dhe burimi kryesor i të ardhurave të familjes.

Banesa ku familja e Hatixhes jetonte, ishte në kushte shumë të vështira. Me kredinë e marrë në vitin 2012, ajo riparoi çatinë e shtepisë e cila më parë pikonte sa herë binte shi jashtë.

Me dy kreditë e tjera të marra pranë A & S Fund, Hatixhe përsëri ndërhyu në pjesë të caktuara të shtëpisë të cilat ishin shumë të dëmtuara dhe jashtë funksionit. Ajo është shumë mirënjohëse ndaj institucionit sepse ka gjetur mbështetje në momentet e saj më të vështira.



***"With the help of Agro & Social Fund, I have improved the life conditions of my family" – says Hatixhe.***

*Hatixhe is 65 years old and is a "hero" mother of six children. Some of her children are still dependent and go to school. Her husband has been paralyzed few years ago and Hatixhe has to fight by herself to provide the income for the family. They live in the village of Griqan Poshte, Elbasan.*

*In 2011, Hatixhe applied for the first loan at A & S Fund. She used it for agriculture since it is the main source of income of this family.*

*The house where Hatixhe's family lives in has been in very poor conditions. With the loan that Hatixhe took in 2012, she replaced the roofing of their house because the previous one leaked and the rain water was getting inside.*

*With two other loans that took at A & S Fund, Hatixhe made other basic repairs needed in the house. She is very grateful to the institution because has found support in her most difficult moments.*